

**REZOLUTË**  
**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2010**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin kushtetues të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e pavarur të politikës monetare;

Duke njohur objektivat afatmesëm e vjetorë, si dhe detyrimet ligjore të institucionit;

Duke marrë në konsideratë ndikimin e zhvillimeve ekonomike botërore, rajonale e kombëtare në politikën monetare të ndjekur nga institucioni;

Duke mbështetur dhe nxitur bashkëpunimin me këtë institucion;

**Konstaton se gjatë vitit 2010 Banka e Shqipërisë:**

- Ka vijuar zbatimin e një politike monetare në funksion të konsolidimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, në kushtet kur ekonomia globale dhe ajo e vendeve të rajonit vazhdojnë të luhaten;

- Ka realizuar objektivin e saj kryesor, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke e mbajtur nivelin e inflacionit brenda kufijve të programuar;

- Ka koordinuar politikën monetare me atë fiskale, duke rritur stimulin monetar në ekonomi dhe duke nxitur zhvillimin e tregut të brendshëm financiar;

- Me politikat e ndjekura, veçanërisht nëpërmjet shënjestrimit të normave afatshkurtra të interesit dhe minimizimit të luhatjeve të tyre, si dhe reduktimit të vazhdueshëm të normave të interesit për kreditë afatgjata, ka ndikuar në rritjen e kreditimit të biznesit dhe zgjerimin e investimeve;

- Ka forcuar rolin mbikëqyrës ndaj sektorit bankar, nëpërmjet mbajtjes së një niveli kapitali të mjaftueshëm për përballimin e rreziqeve të mundshme të kreditimit, përmirësimit të kuadrit organizativ e rregullator të mbikëqyrjes bankare dhe respektimit të kërkesave të tjera ligjore në këtë fushë;

- Ka forcuar rolin mbikëqyrës ndaj çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave në sektorin bankar;

- Ka ruajtur rezervën valutore në kufijtë e programuar;

- Ka mbështetur proceset integruese të vendit tonë në BE dhe ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunuese me institucionet kryesore financiare kombëtare e ndërkombëtare.

**Kuvendi kërkon që, për vitin 2011, Banka e Shqipërisë të përqendrojë punën në këto drejtime:**

- Koordinimin e politikave të saj monetare me ato fiskale të Qeverisë, për të bërë të mundur ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit, realizimin e objektivit të rritjes së prodhimit të brendshëm, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit privat;

- Ruajtjen e stabilitetit të çmimeve brenda normës së inflacionit të parashikuar në programin monetar, si faktor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, ruajtjen e nivelit të jetesës së qytetarëve dhe zgjerimin e vazhdueshëm të konsumit;

- Forcimin e mëtejshëm të rolit mbikëqyrës ndaj sistemit bankar, rritjen e bashkëpunimit me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe me të gjitha institucionet mbikëqyrëse e rregullatore, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të sistemit financiar të vendit;

- Rishikimin e kuadrit ligjor e nënligjor të institucionit, për t'iu përgjigjur më mirë zhvillimeve të ekonomisë botërore, të rajonit dhe atyre të ekonomisë sonë;

- Zbatimin e politikave që synojnë rritjen e kreditimit të ekonomisë, veçanërisht të sferës prodhuese, e shoqëruar kjo me uljen e kostos së kreditimit, si dhe përmirësimin e marrëdhënieve midis sektorit privat dhe atij bankar;

- Rritjen e transparencës së bankave ndaj qytetarëve, reduktimin e kostos së shërbimeve bankare, si dhe rritjen e gamës së shërbimeve për qytetarët dhe biznesin.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

Tiranë më, 9 qershor 2011